

Të nderuar gazetarë, përfaqësues të mediave,

Kam kënaqësinë që po takohemi sot për të shënuar bashkërisht fundin e një viti të suksesshëm për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe për sistemin financiar të vendit, i cili me aktivitetin e tij ka vazhduar të jetë kontribuues shumë i rëndësishëm në mbështetjen e zhvillimit dhe stabilitetit të ekonomisë së vendit.

Pjesë e këtij sukse si pa dyshim është komunikimi efektiv që gjatë gjithë kohës e kemi mirëmbajtur me mediat. BQK-ja në vazhdimësi i ka kushtuar vëmendje të veçantë transparencës me publikun, duke qenë të hapur ndaj mediave për të gjitha çështjet e interesit publik. Me qëllim të avancimit të mëtejshëm të bashkëpunimit tonë, ne gjatë këtij viti kemi organizuar edhe një punëtori me gazetarë në të cilën kemi pasur rastin të bashkëbisedojmë për së afërmi për tema të rëndësishme të lidhura me punën e BQK-së dhe sistemit financiar të Kosovës. Për më tepër, me qëllim të lehtësimit të qasjes në informata për gazetarët, ne kemi emëruar edhe një zëdhënës të BQK-së i cili në masë të masë madhe ka lehtësuar komunikimin ndërmjet BQK-së dhe mediave. Të gjitha këto tregojnë se ne po vazhdojmë ta avancojmë transparencën tonë ndaj publikut dhe mbetemi të përkushtuar të vazhdojmë kështu edhe në të ardhmen.

Tani, më lejoni ju lutem që të shpalos para jush një përmbledhje të zhvillimeve që karakterizuan ekonominë e vendit dhe sistemin financiar gjatë vitit 2018, duke marrë për bazë të dhënat e fundit që i kemi në dispozicion.

Vlerësimet preliminare sugjerojnë se ekonomia e vendit gjatë vitit 2018 shënoi një normë reale të rritjes prej rreth 4%, e mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës së

brendshme, përderisa thellimi i deficitit tregtar kishte ndikim negativ në normën e rritjes. Në kuadër të faktorëve me ndikimin më të rëndësishëm në financimin e rritjes ekonomike ishin përshpejtimi i rritjes së kreditimit për sektorin privat, rritja e shpenzimeve publike, si dhe rritja e remitencave të cilat deri në muajin shtator arritën vlerën 587.9 milionë euro e cila është për 6.1% më e lartë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Ritëm të ngjashëm të rritjes ekonomike, sipas parashikimeve të BQK, ekonomia e Kosovës pritet të ketë edhe gjatë vitit të ardhshëm kur norma reale e rritjes pritet të jetë rreth 4.2%.

Për sa i përket zhvillimeve në nivelin e përgjithshëm të çmimeve, norma mesatare e inflacionit deri në fund të vitit 2018 pritet të jetë rreth 1%.

Aktiviteti i sektorit bankar edhe gjatë këtij viti u karakterizua me rritje të kreditimit, përmirësim të kushteve për qasje të sektorit privat në kredi, si dhe përforcim të mëtejshëm të gjendjes së qëndrueshmërisë. Kreditë e sektorit bankar arritën shumën prej 2.7 miliard euro në tetor 2018, duke shënuar rritje vjetore prej 11.6%. Burimi kryesor i financimit të aktivitetit të sektorit bankar vazhdojnë të jenë depozitat, vlera e të cilave gjatë kësaj periudhe arriti në 3.2 miliard euro që paraqet një rritje vjetore prej 6.9%.

Normat e interesit në kredi vazhduan trendin rënës, duke zbritur në 6.6% nga 6.8% sa ishin në periudhën e njëjtë të periudhës së kaluar, gjë që tregon për lehtësim të vazhdueshëm të qasjes në financim bankar. Treguesit e shëndetit financiar vazhduan të tregojnë nivel të lartë të qëndrueshmërisë së këtij sektori në të gjitha aspektet. Vlen të theksohet posaçërisht cilësia shumë e mirë e portofolit kreditor me një normë

të kredive joperformuese prej vetëm 2.7% në tetor 2018, e cila shënoi rënie të mëtutjeshme në krahasim me vitin e kaluar kur ishte 3.6%.

Me zhvillime të favorshme u karakterizuan edhe sektorët tjerë përbërës të sistemit financiar. Vlera e aseteve të sektorit pensional në shtator 2018 arriti në 1.76 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 11.2%. Kthimi nga investimet e fondeve pensionale vazhdoi të jetë pozitiv, gjë që tregon për rritje të vlerës së kursimeve pensionale të qytetarëve.

Sektori i sigurimeve vazhdoi të rrisë aktivitetin sigures, si dhe kompensimin e dëmeve për të siguruarit. Gjithsej vlera e shkruar e primeve nga kompanitë e sigurimeve në shtator 2018 ishte 69.1 milion euro, e cila paraqet një rritje vjetore prej 4.8%. Në anën tjetër, vlera e dëmeve të paguara arriti në 31.5 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 8.2%. Rritja e dëmeve të paguara, përveç rritjes së numrit të policave të sigurimit, reflekton edhe sjelljen më të përgjegjshme të kompanive të sigurimit ndaj të siguruarve.

Sektori i sigurimeve ka vazhduar që për të dytin vit me radhë të ketë performancë financiare pozitive, gjë që paraqet një zhvillim shumë të rëndësishëm për qëndrueshmërinë e këtij sektori.

Një sektor tjetër i rëndësishëm i sistemit financiar është sektori i institucioneve mikrofinanciare, i cili po vazhdon ta përshpejtojë ritmin e kreditimit duke u shndërruar në një sektor që çdo ditë e më tepër po i kontribuon rritjes së konkurrencës në tregun e kredisë. Gjithsej vlera e kredive të këtij sektori në tetor

2018 arriti vlerën prej 177.7 milion euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 29.1%. Sidoqoftë, një rënie e normës së interesit nga niveli aktual mesatar prej 23.1% do ta bënte këtë sektor edhe më konkurrues dhe me rol më të madh në mbështetjen e ekonomisë së vendit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me të gjitha kapacitetet e saj ka vazhduar të jetë në funksion të mbështetjes së zhvillimit të qëndrueshëm të sistemit financiar, duke e ofruar të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të mbështetur zhvillimin e institucioneve financiare dhe në të njëjtën kohë duke u siguruar se veprimtaria e tyre siguron stabilitet financiar. Harmonizimi i kornizës rregullatore me zhvillimet e fundit ndërkombëtare në këtë fushë, më konkretisht në Bashkimin Evropian, ka vazhduar të jetë prioritet i rëndësishëm i BQK-së edhe gjatë këtij viti, me ç'rast janë përpiluar rregullore të ndryshme të cilat avancojnë aspekte të ndryshme të rregullativës bankare siç janë Rregullorja e SNRF 9 *Instrumentet Financiare* dhe Rregullorja për Kreditë Jo-Performuese dhe Ristrukturimet. Aplikimi i Rregullores SNRF 9 *Instrumentet Financiare* do të rezultojë me rezerva më të ulëta për humbjet nga kreditë në nivel të sektorit bankar si dhe do të zvogëlojë koston përgatitjes dhe auditimit të pasqyrave financiare të bankave pasi që bankat do të raportojnë vetëm sipas kornizës ndërkombëtare të raportimit financiar – IFRS. Rregullorja për Kreditë Jo-Performuese dhe Ristrukturimet do të mundësojë aplikimin e kritereve të njëjta të identifikimit të Kredive Joperformuese dhe Ristrukturimeve dhe është në pajtueshmëri të plotë me kriteret e aplikuar në BE.

Në vitet e fundit, BQK-ja ka rritur angazhimin e saj edhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve të shërbimeve financiare, duke i shërbyer kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjes së interesit të publikut. Angazhimi i tillë, qoftë

përmes programeve të edukimit financiar, qoftë përmes masave korrektuese ndaj institucioneve financiare, do të rritet edhe më tutje gjatë periudhave në vijim.

Gjatë vitit që po lëmë pas, përveç avancimit të kapaciteteve të brendshme, BQK-ja ka qenë shumë aktive në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, me ç'rast dëshiroj ta theksoj nënshkrimin e marrëveshjes së mirëkuptimit me Bankën Qendrore Evropiane, e cila i hapë rrugë rritjes së bashkëpunimit me këtë institucion. Po ashtu, rëndësi të veçantë ka arritja e sigurimit të kodit ndërkombëtar LEI për Republikën e Kosovës, e cila i mundëson Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës një trajtim të barabartë me bankat tjera qendrore në realizimin e transaksioneve financiare.

Një shpalosje më të detajuar të zhvillimeve ekonomike e financiare, si dhe të aktiviteteve të BQK-së gjatë vitit 2018 do të mund ta gjeni në Raportin Vjetor të BQK-së i cili do të publikohet në pjesën e parë të vitit të ardhshëm.

Para se të kalojmë te pyetjet e juaja, dëshiroj të ju njoftoj se BQK-ja edhe në këtë vit ka vazhduar me shpalljen e konkursit, tani më tradicional, për çmimin “Ekonomist i Ri”, me ç'rast dëshiroj t'i falënderoj dhe përgëzojë të gjithë kandidatët për punimet e tyre që i kanë dorëzuar në kuadër të kësaj gare. Ky aktivitet ka për qëllim nxitjen e aktivitetit hulumtues në fushën e ekonomisë në mesin e të rinjve.

Bazuar në vlerësimin e komisionit profesional për vlerësimin e këtyre punimeve, unë sot kam kënaqësinë që të shpallë tri punimet fituese të këtij çmimi, duke shpresuar se kjo do t'i motivojë autorët e këtyre punimeve dhe të rinjtë e tjerë që të vazhdojnë dhe ta avancojnë edhe më tutje punën e tyre hulumtuese.

Vendi i parë i është dhënë autorit **Jeton Zogjani** me punimin **“Efikasiteti dhe Ndikimi i Shërbimeve Elektronike Bankare: Evidencë nga Kosova”**

Vendi i dytë i është dhënë autores **Venera Ratkoceri** me punimin **“Ndikimi i Remitencave dhe Investimeve të Huaja Direkte në Rritjen Ekonomike: Evidencë nga Shqipëria”**.

Vendi i tretë i është dhënë autorit **Bedri Hasanaj** me punimin **“Karakteristikat e rritjes ekonomike të Kosovës në dekadën e fundit”**

Në përfundim, më lejoni t’ju falënderoj përzemërsisht për bashkëpunimin, profesionalizmin dhe korrektësinë që keni treguar në mbulimin e zhvillimeve financiare dhe ekonomike gjatë këtij viti dhe t’ju uroj shumë shëndet, lumturi e suksese juve dhe familjeve tuaja për vitin 2018.

Tani mirëpres pyetjet tuaja.